



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 31, Datë 09.02.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR
SIGURIMIN E AKSESIT TË PALËVE TË TRETA NË SISTEMIN E
TRANSMETIMIT DHE TRANSPARENCËN NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 42, pika 3 dhe nenit 48 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”; nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016” si dhe parashikimeve të Vendimit nr. 2018/01/PHLG-EnC, datë 12.01.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 09.02.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror”,

Konstatoi se,

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e ligjit, në bazë të nenit 42 pika 3 dhe nenit 48 të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” ERE miraton rregullat për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror.
- “Draft- Rregullat për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror”, janë hartuar në përputhje me referencat në Rregulloren e Komisionit (KE) Nr. 715/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullave për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror.”

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI